



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i II-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Më 02.05.2024

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Sabedin Vishi, Nën kryetarë

Zahir Doda, DKA

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Bujar Bajra-Sektori i Emergjencave Civile Komunale

Fadil Guri-ZKK

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Berat Babaj-FSK

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet e pa shpërthyer nga lufta
- 4.Shenjat sinjalizuese,trotuaret dhe hapsirat publike në territorin e komunës
- 5.Të ndryshme

1.Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Në pikën e dytë të rendit të ditës për periudhën në mes dy takimev Kryetari fjalën ia dha Komandantit të Stacionit të Policisë në Kaçanik z. Halim Shehut.

Halim Shehu – Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë. Kemi gjithsejtë 58 raste ku prej tyre më shqetësuese është dukuria e vjedhjeve të rënda ku gjithsejtë janë 8 raste , vjedhje në tentativë 2 raste , vjedhje e Pyjeve 1 rastë , vjedhje e veturës 1 rastë , dëmtim prone 3 raste , kanosje 6 raste ,3 raste të sulmeve , dhunë në familje 6 raste , 4 raste lëndime të lehta trupore , fallsifikim i parasë 1 rastë , lëndime aksidentale 4 raste , si pasojë e lëndimeve të shfaqura në vende të punës si pasojë e mos marrjes së masave të sigurisë në punë nga punëmarrësi , posedim i lëndëve narkotike 2 raste , armëmbajtje pa leje 1 rast , kallëzim i rremë 1 rast , incident i zjarrit 2 raste . zjarrvënie 2 raste dhe nga një rast aksident trafiku dhe person i zhdukur .

Thënë në Përgjithësi gjendja e sigurisë është e qetë dhe stabile dhe në krahasim me Komunat tjera jemi ndër Komunat më të qeta në vend.

Shqetësuese është mungesa e hapësirave për parkingje dhe kjo qështje i takon organeve Komunale ta trajtojnë e gjithashtu menagjimi jo i mirë i pyjeve sidomos në pjesën e Parkut Nacional .

3.Vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjetet e pa shpërthyer nga lufta

Lidhur me vetëdijësimin e nxënësve për rrezikun nga minat dhe mjeteve tjera të pa shpërthyer nga Lufta Kryetari fjalën ja dha Drejtorit të Arsimit .

Zahir Doda – U jemi falënderues FSK-së që me projektet e tyre profesionale kanë bërë një punë të mirë sa i përket kësaj teme dhe deri më tani shumica e nxënësve veq janë të njoftuar lidhur me rreziqet nga minat dhe mjeteve të pashpërthyer nga Lufta.

Ligjërata janë mbajtur edhe për mjetet piroteknike sidomos në periudhën e ndërrimit të motmoteve.

Gatishmëria për bashkpunim egziston dhe ne do të vazhdojmë me aktivitetet vetdijsuese lidhur me këtë temë .

Berat Bobaj – FSK që nga viti kaluar ka filluar një kampanjë rreth kësaj teme dhe falë bashkëpunimit të mirë me Drejtoritë e Arsimit ne kemi zhvilluar aktivitete vetdijsuese .

Në bazë të hulumtimeve që kemi bërë pjesa më e madhe e hapësirave të minuara janë pastruar por që nuk mundë të themi se ka kaluar rreziku potencial andaj apeloj që nëse dyshohet për ndonjë mjet të informohen KFOR , FSK dhe Policia e Kosovës për mes kontakteve që janë të publikuara në numra të telefonit .

Kryetari – FSK ka ekipe të profesonalizuara për temën që po e diskutojm dhe trajnimet që i ofrojn janë të mirëseardhura .

4. Shenjat sinjalizuese, trotuaret dhe hapsirat publike në territorin e komunës

Kryetari – Ka kërkesa të shumta të qytetarëve për trotuare dhe ne mundohemi që me këtë buxhet që kemi të intervenojm duke u bazuar në prioritete .

Nuk qëndrojm keq sa i përket trotuareve por që kërkesat janë të shumta dhe ne në vazhdimësi do të angazhohemi në këtë drejtim .

Sa i përket shenjave sinjalizuese ne si Komunë e kemi të kontraktuar një kompani e cila ka bërë sinjalizimin dhe shenjëzimin dhe për shkak të dëmtimeve që bëhen ata me sugjerimin tonë intervenojn në riparim .

Jashar Selimi – Para stacionit të Policisë janë 5 parkingje të rezervuara por që persona të pa ndërgjegjshëm i parkojnë automjetet e tyre dhe kërkesa e ime është që të vendoset një shenjë në këtë hapësirë .

Halim Shehu – Në përgjithësi rrugët kanë shenja sinjalizuese me përjashtim në disa vende ku janë dëmtuar por që kompania ka intervenuar në riparimin e tyre .

Edhe shenjëzimi vertikal e horizontal si dhe shenjat orientuese egzistojn pothuajse në tërë territorin e Komunës .

Gjithashtu ne jemi përkujdesur edhe për krasitjen e drunjëve të cilët kanë kamufluar këto shenja .

Qështja e trotuareve përpos rrugës Qamil Ilazi që ka mangësi të gjitha rrugët tjera janë të pajisura edhe me trotuar.

Është duke u punuar edhe te pjesa e hapësirës që është pran ETC-ës që po mendoj do të jetë e gatshme shumë shpejtë .

Menduh Krasniqi – Sinjalizimi dhe shenjëzimi i rrugëve ka qënë prioritet i Komunës edhe në këtë drejtim nuk qëndrojmë keq .

Së bashku me Policinë e Kosovës ne kordinohemi ne ato vende që ata vërejnë ndonjë rrezik potencial për mungesë të shenjzimit apo sinjalizimit dhe intervenojmë.

5. Të ndryshme

Kryetari – Hapësirat publike në Qytet janë të kufizuara por që ne së bashku mund të punojmë në identifikimin e këtyre hapësirave për shfrytëzim më të mirë për qytetarët .

Fidaim Fazliu – Afër xhamisë është një objekt (trafikë) që nuk shfrytëzohet por që paraqet pengesë për qasje në disa lokale te Xhamisë .

Është mirë të shqyrtohet kjo qështje nga Komuna dhe të bëhet një zgjidhje .

Kryetari – Të bëhet një kërkesë zyrtare dhe ne mundë ta shqyrtojmë kët kërkesë dhe do të shohim mundësin e lirimit të kësaj hapësire nëse është e mundur .

Menduh Krasniqi – Jemi në dijeni rreth kësaj qështje dhe besoj që edhe përmes Drejtorisë së Urbanizmit do të veprojmë dhe besoj se do të bëhet një zgjidhje .

Fadil Guri – Të bëhen kërkesa zyrtare dhe ato kërkesa të shqyrtohen mirë me qëllim që në të ardhmen të mos kemi probleme ligjore .

Objekti në fjal është aty edhe para lufte dhe mund të kemi implikime ligjore nëse marrim një vendim për zhvendosje .

Hapësirat publike rreth Xhamisë janë të pamjaftueshme dhe po paraqesin vështirësi për qarkullim të automjeteve të rënda e në kët rast automjetin e Zjarrëfiksëve që kjo qështje kërkon zgjidhje .

Menduh Krasniqi – Numri i veturave ne Komunën tonë për çdo vit rritet ndërsa hapësirat publike në qytet janë të pamjaftueshme .

Hapësira për rreth Xhamisë është e pamjaftueshme dhe ne për këtë arsyeje e kemi bërë rrugën njëkahëshe dhe nuk kemi lënë hapësirë për parking .

Menduh Krasniqi – Për shkak të punimeve që janë duke u bërë në Hekurudhë ka mundësi që këtë verë të krijohet një kaos në trafikë .

Punimet janë të fokusuara në tunel te Guri i Shhpum dhe magjistralja Kaqanik – Hani Elezit do të bllokohet dhe si rrugë alternative do të mbetet rruga Idriz Seferi nga Guri i Shpumë dhe automjetet do të kenë qasje edhe në qendër të qytetit .

Ne kemi kontraktuar kompaninë dhe i kemi marrë masat paraprake për të evituar ndonjë kaos.

Halim Shehu – Lidhur me kët qështje ne si Stacion i Policisë nuk jemi të informuar .

Menduh Krasniqi – Me siguri që do të njoftohet edhe Policia me kohë në momentin kur ata do të vendosin për fillimin e punimeve .

Jashar Selimi – Një familje në Kaçanik të Vjetër ka uzurpuar një hapësirë të varrezave të fshatit dhe unë po e ngrisë si shqetësim pasi këtu jeni ju Kryetar dhe Kryetari i Bashkësisë Islame .

Kryetari – Qenka një çështje e ndishme dhe po mendoj që të mbajmë një takim të përbashkët me gjitha palët e involvuar .

Fidaim Fazliu – Në raportin e Komandantit të Policisë u përmenden 6 raste të dhunës në familje dhe si dukuri është shqetësuese në tërë vendin .

Ne si Bashkësi Islame kemi zhvilluar aktivitete vetdijësuese nëpër Xhami të cilat aktivitete i kemi organizuar edhe në të kaluarën .

Më intereson të dijë se a janë marrë masa preventive nga institucionet në evitimin e kësaj dukurie ngase rasti i fundit që ndodhi në Ferizaj ishte pikërisht në institucionin që mirret me këtë çështje .

Isha një ditë te zyret e entit social dhe vërejtja se hapësira nuk i plotëson kushtet për natyrën që kërkon mirëqenia sociale .

Po shpresoj që të bëhet një zgjidhje sa i përket objektit të Entit për Punë Sociale me qëllim që të ketë kushte për punë .

Halim Shehu – Kam vizituar objektin e Entit Social dhe mendoj që ky Ent nuk ka kushte për punë .

Janë të zhvendosur përkohësisht në Palestrën Sportive por që nuk shohë ndonjë mundësi që të ndodhë ajo që ka ndodhur në Ferizaj ngase palët në këtë Ent shkojnë pasi të përfundojnë seancat gjyqësore .

Bujar Bajra – Objektin në Palestër e kemi me sigurim nga një kompani dhe punëtorët e sigurimit mirren edhe me palët që frekuentojnë Entin Social .

Zahir Doda – Qështja e Enteve Sociale duhet të zgjidhet në nivel qendre por që këto raste mundë të ndodhin në çdo institucion .

Sa i përket dukurisë së dhunës në familje në Drejtorinë e Arsimit nga gratë Asambleiste është kërkuar që të mbahet një orë shkollore me nxënës .

Kërkesa jonë ka qenë që ata të dërgojnë një përgatitje rreth temës dhe të ju ofrohet shkollave por jo në formën siq kanë kërkuar ato ngase është vetëm si formalitet mënyra që kanë kërkuar ato.

Jam në pritje të përgjigjes dhe ne do ta ofrojmë bashkëpunimin .

Halim Shehu – Ne si Polici e kemi edhe sektorin për komunitet që mirret me trajnime të ndryshme por që paraprakisht marrim konfirmim nga Departamenti për Trajnime për të zhvilluar trajnime nëpër shkolla .

Monitorues në këtë mbledhje ishte zyrtari i OSBE-së Faruk Mustafa

Rekomandimet:

1. Të hulumtohen hapsira për parkingje
2. Një përkujdesje më e madhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e pyjeve sidomos në pjesën e Parkut Nacional që është nën menagjim të nivelit qendrorë
3. Një koordinim i mirë i institucioneve në organizimin e trajnimeve nëpër shkolla rreth temës „Rreziku nga minat dhe mjeteve të pa shpërthyer nga lufta” dhe për tema tjera vetdijsuese
4. Të gjinden forma në sigurimin e kushteve më të mira për objektet institucionale që mirren me qështje të mirëqenjes sociale si dhe të sigurohen nga kompanitë e sigurimit

Kryesoi: Kryetari -z. Besim Ilazi



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka

A handwritten signature in blue ink, which appears to be "Fatmir Qaka", written over a horizontal line.